



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE**  
**KORÇE**

**Nr. 435 Regj. Them**  
**Data e Regj: 08.04.2015**

**Nr.445 Vendimi**  
**Data:21.09.2015**

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

**SOKOL IBI - Gjyqtar**

Asistuar prej sekretares Marinela Rushi, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 21.09.2015, çeshtjen administrative me Nr.435 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

**PADITES:** “Daniel Agolli” person fizik me seli ne Korçe, i perfaqesuar ne gjykim nga shtetasi Daniel Agolli.

**I PADITUR:** 1. **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga;  
2. **Drejtoria e Apelimit Tatimor**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

**OBJEKTI:**

1. Pavlefshmeri absolute permes anullimit te aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.6213/1, date 23.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.
2. Pavlefshmeri absolute permes anullimit te aktit administrative akt konstatimi date 13.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.
3. Pavlefshmeri absolute permes anullimit te aktit administrativ procesverbal gjobe Nr.0067201, date 13.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimre Korçe;

4. Pavlefshmeri absolute permes anullimit te aktit administrativ vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Nr.1411/2, date 09.03.2014.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, ligji Nr.8485, date 12.05.1999, K.Pr.Civile, udhezimi Nr.24, date 02.09.2008, udhezimi Nr.16, date 03.05.2010.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, ne konkluzionet perfundimtare pala paditese perfundimisht kerkoi pranimin e padise, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korce dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

### VEREN

Se paditesi "Daniel Agolli" person fizik e ushtron aktivitetin e tij tregetar ne qytetin e Korçes me fushen e Kreperise.

Ne daten 13.12.2014 inspektoret pales se paditur kane ushtruar kontroll ne aktivitetin tregetar te pales paditese ne baze te urdherit e punes Nr.6041, date 12.12.2014.

Nga ana e inspektoreve e pales se paditur eshte konstatuar se punonjesi i pales paditese nuk ka leshuar kuponin tatimor per sherbimin e ofruar ndaj klientit, duke kryer keshtu kundravajtjen administrative te parashikuar nga neni 122, pika 1 te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.

Ne vendin e ushtrimit te aktivitetit tregetar u gjet e punesuar shtetesja Elisaveta Azis e cila ka refuzuar te nenshkruaje marrjen dijene per aktin e konstatimit e kundravajtjes administrative.

Nga ana e inspektoreve e pales se paditur eshte hartuar edhe procesverbali i gjebes i dates 13.12.2014 dhe i eshte komunikuar personit te punesuar prane pales paditese Elisabeta Azis e cila ka refuzuar te nenshkruaje marrjen dijene per kete procesverbal gjobe.

Me aktin administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.6213/1 Prot, date 23.12.2014 pala e paditur njofton paditesin per detyrimin e tij per te

paguar gjoben ne masen 100.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mosleshimit te kuponit tatimor.

Pala paditese duke mos qene dakort me kete akt administrativ e kundersh-ton ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.1411/2 Prot, date 19.02.2015 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.6213/1, date 23.12.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi kesaj gjykate duke pretenduar se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem sepse eshte nxjerre ne kundersh-tim me proceduren e parshikuar nga ligji. Keshtu pala paditese pretendon se inspektoret e pales se paditur nuk jane paraqitur ne ambjentet e shoqerise tregetare, nuk jane identifikuar si punonjes te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe dhe nuk kane paraqitur urdher te punes.

Pala paditese pretendon se akti administativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte i pabazuar ne prova dhe ne ligj sepse nuk identifikohet subjekti tregetar, pala paditese i ka prere rregullisht kopunat tatimore per sherbimet e ofruara.

Pala paditese pretendon se procesverbali i gjobes duhet ti ishte njoftuar perfaqesuesit e shoqerise, veprim i cili nuk eshte realizuar.

Paditesi nuk eshte degjuar nga administrata tatimore perpara marrjes se vendimit te denimit me gjobe.

Pala e paditur ka prapesuar gjate gjykimit duke pretenduar se pala paditese ka kryer kundravajtjen administrative te mosleshimit e kuponit tatimor. Pala e paditur prapeson duke pretenduar se akti administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ i ligjshem dhe i vlefshem, eshte nxjerre ne perputhje me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji.

Nga theniet e inspektoreve tatimore qe ishin prezent kur u krye kontrolli te pyetur me cilesine e deshmitarit ne gjykim, rezulton se paditesi e ka kryer kundravajten administrative.

Gjate gjykimit rezultoi se inspektoret e pales se paditur kane kryer verifikimin ne teren te aktivitetit tregetar te pales paditese ne baze te urdherit te punes Nr.6041, date 12.12.2014. Pretendimi i pales paditese se nuk ka kryer shitje pa kupon tatimor eshte nje pretendim i pabazuar ne prova. Kuponat tatimore te paraqitur si prove nga pala paditese ne gjykim nuk provojne faktin se pala paditese nuk e ka kryer kundravajten administrative te mosleshimit te kuponit tatimor e cila kryhet qe ne momentin qe pala paditese ka ofruar sherbimin e saj pa leshuar kuponin tatimor.

Fakti qe pala paditese ka ofruar sherbimin e saj pa leshuar kuponin tatimor rezultoi e provuar gjate gjykimit nga theniet e deshmitareve Brikena Merkuri dhe Ornela Çani.

Kuponat tatimore te paraqitura si prove nga pala paditese ne gjykim jane te gjitha te prera pas ores 13.00, nderkohe qe shkelja administrative eshte konstatuar si e kryer nga inspektoret e pales se paditur para ores 10.55, sikurse rezulton e provuar nga akti i konstatimit i dates 13.12.2014.

Pretendimi i pales paditese se inspektoret e pales se paditur nuk jane paraqitur ne ambientet e pales paditese, nuk jane identifikuar dhe nuk kane paraqitur asnje urdher pune eshte nje pretendim i pabazuar ne prova. Lidhur me pretendimin e pales paditese se inspektoret e pales se paditur nuk kane derguar paraprakisht njoftimin per kontroll pales paditese, gjykata cmon se ky pretendim eshte i pabazuar ne ligj, ne te kundert nuk do te kishte kuptim ky kontroll ndaj pales paditese ne baze te ketij urdheri pune.

Lidhur me pretendimin e pales paditese se akti i konstatimit dhe procesverbali i gjobes nuk permban identitetin e punonjesit te pales paditese qe ka kryer kete kundravajtje administrative dhe nuk percaktohet identiteti i bleresit, jane pretendime te pabazuara ne ligj dhe qe nuk passjellin si pasoje qe njoftim vleresimi per detyrimet tatimore te jete nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem.

Lidhur me pretendimin e pales paditese se procesverbali i gjobes nuk i eshte njoftuar perfaqesuesit te pales paditese dhe nuk jane respektuar dispozitat e ligjit Nr.10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative" ne mbajtjen e procesverbalit te konstatimit te kundravajtjes administrative, gjykata cmon se eshte nje pretendim i pabazuar ne prova dhe ne ligj, sepse ky procesverbal gjobe i eshte njoftuar punonjesit te pales paditese qe eshte gjendur prezent, por ky i fundit ka refuzuar marrjen dijene dhe se ne rastin konkret jane respektuar dispozitat e ligjit te

posaçem Nr.9920 "Per procedurat tatimore ne R.SH" dhe jo dispozitat e ligjit "Per kundravajtjet administrative", sikurse pretendon pala paditese.

Po keshtu i pabazuar eshte edhe pretendimi i pales paditese se nga pala e paditur nuk eshte rrespektuar e drejta e pales paditese per tu degjuar perpara marrjes se vendimit te denimit me gjobe.

Nga permbajtja e aktit te konstatimit te dates 13.12.2014, rezulton se ky akt i eshte njoftuar punonjeses se pales paditese Elisabeta Azis e cila ka refuzuar marrjen dijene per kete akt si dhe ka refuzuar mundesine te shprehe pretendimet e saj rreth ketij kontrolli dhe shkeljes administrative te konstatuar.

Per keto arsye njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ i ligjshem dhe i vlefshem. Po keshtu edhe procesverbali i titulluar akt konstatimi i dates 13.12.2014, procesverbali i gjobes i dates 13.12.2014, po ashtu edhe vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lene ne fuqi kete njoftim vleresimi tatimor.

Per keto arsye padia e paditesit eshte e pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille ajo duhet rrezuar nga gjykata.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

### **VENDOSI**

1. Rrezimin e padise, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
  2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.

- U shpall sot me date 21.09.2015 ne Korçe.


**SEKRETARE**

**MARINELA RUSHI**



**GJYQATAR**

**SOKOL IBI**



Shpenzimet gjyqesore:

- 1: Takse pulle 3.000 leke;  
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).

**Shenim:** Vendimi ka marre forme te prere sot ne daten \_\_\_\_\_.

**KANCELAR  
ALEKSANDER DINO**